

RAYMOND CARVER
MË TELEFONO NËSE KE NEVOJË PËR MUA
TREGIME DHE ESE

BOTIMET TOENA

RAYMOND CARVER

MË TELEFONO
NËSE KE NEVOJË PËR MUA

tregime dhe ese

Përktheu nga origjinali anglisht
Klea Vyshka

BOTIMET TOENA

Autori: Raymond Carver (Reimond Karver)

Titulli në original: Call if you need me

Botoi në anglisht: The Harvill Press

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-40-6

© 2000, Tess Gallagher

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 677070884

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Për Georgia Morris Bond

PËRMBAJTJA

TREGIME TË PAPËRMBLEDHURA.....	23
Shkarpa	25
Çfarë dëshiron të shohësh	44
Ëndrrat.....	68
Vandalët.....	82
Më telefono nëse ke nevojë për mua.....	101
PESË ESE DHE NJË MEDITIM	117
Jeta e tim ati	119
Mbi të shkruarin.....	134
Zjarre.....	143
Xhon Gardner, shkrimtari si mësues.....	162
Miqësia.....	176
Meditim mbi një rresht të Shën Terezës.....	184
TREGIME TË HERSHME.....	189
Stinë të furishme	191
Qimja.....	216
Aficionados	221
Poseidon dhe kompani	230
Mollë të kuqe flakë.....	233

FRAGMENT I NJË ROMANI	243
nga Shënimet e Agustinës	245
ÇASTE.....	257
Mbi “Fqinjët”	259
Mbi “Të pish duke ngarë makinën”	262
Mbi procesin e të rishkruarit	264
Mbi skenarin “Dostojevski”	269
Mbi “Mbiujëse” dhe poezi të tjera	276
Mbi “Për Tesin”	282
Mbi “Porosi”	286
Mbi “Nga ku po thërras”	289
PARATHËNIE	295
Në drejtim të yjeve.....	297
Gjithë marrëdhëniet e mia.....	302
Çehovi i panjohur.....	319
Letërsi e ndodhisë dhe e pasojave.....	321
Mbi letërsinë bashkëkohore	328
Mbi tregimet më të gjata	331
KRITIKA LIBRI.....	341
Peshk i madh, peshk mitik	343
Komeditë çnjerëzore të Bartelmit	348
Rrëfenja ngazëlluese	353
Zogu i kaltër, paralajmërim stuhie	360
Një romancier i talentuar në kulmin e krijimtarisë	366

Letërsi që hedh dritë mbi errësirën	371
Brotigani na shërben “Mjedra Njeriu-ujk” dhe “Pjepër Maceje”	375
Mekguenin dhe loja e madhe	379
Vizioni i qartë i Riçard Fordit mbi humbjen, shërimin	383
Një akrobat i dalë në pension magjepset pas një vajze adoleshente	387
“Fama s’është gjë, ta them unë”	391
Ngjitja dhe rënia.....	401

Parathënie

“Janë të fundit”, i shkrova një miku gjatë procesit njëvjeçar të përgatitjes për botim të pesë tregimeve të sapozbuluara të Reimond Karverit. Si poete, dëgjoj gjithashtu në këtë frazë një jehonë “pafundësie”. E megjithatë kjo është gjithçka e re që ka mbetur nga ai zë i jashtëzakonshëm, dëshmia e qartë e ndershmërisë së paepur të tregimeve të tij, të përkthyer në mbi njëzet gjuhë të botës.

Kur Haruki Murakami, romancieri i shkëlqyer dhe përkthyesi në japonisht i Reit, më bëri vizitë bashkë me gruan, Jokon, pas vdekjes së Reit, më zbuloi se ndihej i shoqëruar prej pranisë së Reit dhe tmerrohej prej mendimit se duhet të përfundonte botimin e tij të plotë të punëve të Reit. Tani e kuptoj përzierjen mes kënaqësisë dhe trishtimit që duhet të ketë ndier.

Një lloj kënaqësie të kaplon në këtë përpjekje tonën, kur dëgjon diçka të re që del nga një zë, i cili dukej sikur e kishte lënë këtë tokë, kur gëzohesh prej hyrjes së tij të papritur pasi ka rënë perdja e skenës. Nëse do të gjendej sot, një arkë me dorëshkrimet e Kafkës ose Çehovit, njerëzit do të përlesheshin për të parë se ç’ka brenda. Ne jemi kështu, kureshtarë, nostalgjikë, të etur për hijet e njohura të atyre që admirojmë në letërsi dhe në jetën tonë.

Këto zbulime të punëve të reja janë ndodhi të veçanta, por prapëseprapë të lidhura me punët që Rei botoi kur ishte gjallë. Ka një vlerë për ata që duan ta gjejnë, sepse kur na pëlqen një shkrimtar, duam të lexojmë e të lexojmë prej tij, të njihemi me masën e plotë të asaj çka ai apo ajo ka shkruar: transcendenten, të papriturën, madje edhe të papërfunduarën. Jemi në gjendje. Kjo vlerë nuk vjen vetëm nga e përgjithshmja, por edhe nga gjërat e vogla: fjalitë dhe sintaksa, njohja apo habia e personazheve, subjekti varg pas vargu i rrëfimit.

Zbulimet e këtyre tregimeve ndodhën në kohë të ndryshme e në vende të ndryshme. I pari ndodhi në mars 1999 në Rixh Haus, Port Anxheles në Uashington, në shtëpinë ku unë dhe Rei jetonim kur ai vdiq. Xhei Udruf (Jay Woodruff), një mik dhe redaktor i *Esquire*, më ndihmoi në këtë proces. I dyti ndodhi në mesin e asaj vere, kur Uilliam L. Stalli (William L. Stull) dhe Morin P. Karol (Maureen P. Carroll) burrë e grua partnerë të bursës Karver, vizituan Koleksionin Uilliam Çarvat (William Charvat) të Letërsisë Amerikane në Bibliotekën e Universitetit Shtetëror të Ohajos. Aty, ndërkohë që zhbirilonin një kuti me dorëshkrime, gjetën dy tregime të plota, të pabotuara. Më morën në telefon për të më treguar lajmin, të emocionuar, në ditën e ditëlindjes sime.

Qe bollëk mbi bollëk kur këto dy tregime iu bashkuan të triave që arritëm të gjejmë unë dhe Xhei. Për më tepër, ishte një terren mbi të cilin mund të ribotonim tregimet e papërmbledhura të Reit. Shumë

prej këtyre shkrimeve qenë botuar më parë te “S’ka heroizma, të lutem” (botuar nga *Harvill Press* në Britaninë e Madhe dhe nga *Vintage Books* në Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Përpos këtyre tregimeve të pabotuara, e kemi pasuruar edhe më tej këtë libër me katër ese që janë botuar më parë te “Zjarre”, dhe një përzierje poezish e prozash të vitit 1983.

Pak pas vdekjes së Reit, ndërkohë që shkruaja parathënien e “Rrugë e re drejt ujëvarës”, kisha gjetur disa dosje që përmbanin dorëshkrime të shtypura dhe të shkruara me dorë të tregimeve të pabotuara. Në atë kohë nuk isha e sigurt nëse ishin dorëshkrime të përfunduara, ose nëse duhet ta shihnin dritën e botimit, në rast se qenë të tilla. Mendova se para se të merrnim në shqyrtim punët e pabotuara, duheshin përgatitur si fillim gjithë shkrimet e tjera që Rei kishte dashur qartësisht të botoheshin. Do të duheshin nëntë vjet për ta arritur këtë, me botimin e përmbledhjes poetike të Reit, “Të gjithë ne” (Harvill, 1996; Knopf, 1998).

Kishte plot gjëra për të bërë pas vdekjes tejet të parakohshme të Reit në moshën pesëdhjetëvjeçare, në 1988 nga kanceri i mushkërive. Pashë tre prej librave të tij të botoheshin nga shtëpi botuese britanike e amerikane, mbarova “Vendi Karver”, një libër fotografish nga Bob Adelmani dhe dhashë këshilla mbi filmin e Robert Altmanit, *Short Cuts*, i cili frymëzohej nga nëntë tregime të botuara të Reit. Mora pjesë në prodhimin e tre filmave dokumentarë mbi Rein. Shumë prej gjërave të përmendura më lart,

i kam bërë ndërkohë që jepja mësim larg shtëpisë. Në një mënyrë apo në një tjetër, ia dola të shkruaj edhe tre libra me poezi, një libër me tregime dhe një përmbledhje esesh.

Herët në vitin 1998, teksa përvjetori i dhjetë i vdekjes së Reit po afrohej, Xhei Udruf më mori në telefon për të më thënë se donte të bënte diçka në kujtim të Reit në *Esquire*. “Ka disa dosje në tryezën e punës”, i thashë. “Mund të mos ketë asgjë të përfunduar apo me vlerë, ama mund t’i hedh një sy ndonjë ditë.” Ma merr mendja se Xhei e ndjeu hezitimin në zërin tim. Gjithsesi, ai ma ktheu: “Tes, kur të jesh gati t’i shikosh ato dorëshkrime, unë vij me gjithë qejf për të të ndihmuar”.

Xhei dukej pikërisht personi i duhur që kisha shpresuar të vinte. Ai e respektonte punën time, i pëlqente shumë shkrimet e Reit dhe e kuptonte procesin e rishkrimit dhe të botimit. Për më tepër, edhe si shkrimtar, edhe si redaktor reviste, Xhei arrinte t’i dallonte tregimet e mira kur i lexonte. Në marsin e vitit 1999 ai mori avionin për Siatëll dhe udhëtoi edhe tri orë të tjera, me makinë dhe traget, gjer në Port Anxheles. Ditën tjetër, nga ora nëntë e mëngjesit deri në njëmbëdhjetë të natës, shqyrtuam me kujdes ato çka përmbante çdo sirtar i tryezës së punës së Reit. Lexuam faqet nëpër dosje, i emërtuam dhe i fotokopjuam dhe, më në fund, zgjodhëm. Ishte proces i heshtur e intim, plot me qëllim në vetvete. Ndërkohë që lexonim, u bë e qartë se kishim të bënim me tri tregime të mira. Tmerri që kisha ndër

tek i afrohesha copëzave të fundit të punës së Reit iu nënshtrua perspektivës se po bëja diçka të mirë me këto tregime të pabotuara. Më dukej tejet e udhës që *Esquire*, ku tregimet e Reit gjetën lexueshmërinë e tyre të gjerë për herë të parë në fillimvitet 1970, të merrte pjesë në këtë zbulim.

Xhei mori përsipër deshifrimin e shkrimit të dorës tejet të dendur të Reit, për të bërë transkriptime të sakta. Një dorëshkrim ishte i gjithi me shkrim dore, ndërkohë që të tjerët ishin të shtypur dhe me korrigjime të bëra me shkrim dore. Jo vetëm që s’e konsideroi këtë punë si të lodhshme, por Xhei u mbush me energji falë kësaj detyre. Meqë kisha kaluar njëmbëdhjetë vjet duke u përpjekur të deshifroja shkrimin e dorës së Reit, kontrollova transkriptimet e Xheit fjalë për fjalë duke i krahasuar me origjinalin për të plotësuar ca hapësira që ai s’i gjente dot. Të dy e dinim se Rei ndonjëherë arrinte gjer aty sa ta rishkruante një tregim tridhjetë herë. Këto tregime qenë vënë mënjanë shumë më parë sesa të ndodhte kjo. (Në muajt e fundit të Reit, ai u kthye nga proza drejt poezisë, për atë që do të bëhej libri i tij i fundit, “Rrugë e re drejt ujëvarës”). Gjithsesi, u desh shumë pak redaktim për këto tregime. Emrat e personazheve dhe të vendeve ishin të standardizuara, ndaj Doti nuk bëhej Dolores disa faqe më vonë, as Eureka nuk bëhej Arkata. Përfundimet, aty ku Rei gjithnjë punonte më fort, ishin lënë në disa raste siç lihet një vakt kur bie telefoni. Ne thjesht i lamë ato çastet e fundit të kumbojnë, duke e lejuar tregimin të bjerë në qetësi.

Rei ka shkruar disa përshkrime njerëzish që përpiqen t'ia fillojnë nga e para, sidomos te “Nga ku po thërras”. Te “Shkarpa”, tregimi i parë nga ato që u botuan në *Esquire*, një burrë që përpiket dëshpërimisht të çajë një turrë me dru, përpiket të qartësojë vullnetin e tij për të vazhduar përpara pas alkoolizmit dhe një martese të dështuar. Rrëfyesi është gjithashtu shkrimtar dhe përpjekjet e tij për të shkruar sërish jehojnë me emocion periudhën gjatë 1979-s kur Rei dhe unë filluam jetën tonë bashkë në El Paso dhe kur ai ia filloi nga e para pas një periudhe dhjetëvjeçare alkoolizmi.

Nga pesë tregimet e reja, “Ëndrrat” u bë e parapëlqyera ime dhe e Xheit. Këtu, një grua humbet fëmijët e saj në një zjarr, pas dështimit të martesës së saj. Tregimi dukej sikur lidhte jetët tona në Sirakuzë (ku Rei dhe unë flinim, si çifti në tregim, në katin përdhes për t'i shpëtuar vapës së gushtit) dhe në Northuest (ku kishte rënë një zjarr në rrugën tonë, edhe pse pa viktimë). Aty njoha jehonën e tregimit të Reit “Një gjë e vogël, e mirë”, ku, gjithashtu vdes një fëmijë. Në të dyja rastet e admiroj guximin e Reit që iu fut një teme që mund të kthehej shumë thjesht në sentimentale. Te “Ëndrra”, hollësitë shpalosen njëra pas tjetrës, siç del tymi nga oxhaku, veprimi zhvillohet në *chiaroscuro*: skena shfaqet e turbullt, shkëlqen, pastaj shpërthen. Jetët e këtyre personazheve janë kaq të zhveshura nga rrethanat, saqë shndërrohen në vetë jetët tona.

Dy tregimet që zbuluan Billi dhe Morina datojnë prej 1980-s dhe të dyja flasin për martesa të dështuara.

Një prej tyre “Më telefono nëse ke nevojë për mua”, i paraprin imazhit qendror të tregimit “Blackbird Pie” dhe poemës “Natën vonë me bretkosat e kuajt”. Në secilën prej këtyre pjesëve, shfaqen mistershëm kuaj nëpërmes mjegullës, gjatë ndarjeve fatale. Tregimi tjetër, “Çfarë dëshiron të shohësh”, duket sikur është kushëri me “Shtëpi shefi”, në secilin ka një burrë e një grua, të cilët duke u përpjekur t’i sjellin jetët e tyre sa më pranë njëri-tjetrit, mbeten aq të lënduar, saqë në fund u duhet të ndahen. Imazhi përmbyllës i prishjes sjell ndër mend tregimin e Reit “Ruajtja” në kuptimin që marrëdhëniet, ashtu si ushqimi i ngrirë që lihet të shkrihet, mund të prishen dhe, pas një pike të caktuar, nuk i shpëton dot më.

Kur të gjitha tregimet, veç njërit, ishin botuar në seri, Geri Fisketxhon (Gary Fisketjon), mik dhe redaktor i Reit filloi t’i rilexonte sërish bashkë me mua. Në një pikë të caktuar vumë re se po hiqnim presjet që kishim shtuar. Qeshëm dhe cituam Rein, kur thoshte se nëse e gjen veten duke hequr atë që sapo shtove, kjo është një shenjë që tregimi ka mbaruar.

Së fundmi, rilexova katër esetë të “Zjarre” që përfshihen në këtë vëllim. E ndjeva “Jeta e tim ati”, po ashtu siç e kisha ndier për herë të parë kur Rei ma dha ta lexoja si dorëshkrim të hershëm. Duhet të jetë një nga përshkrimet më emocionuese të dashurisë së birit për babain. Në një skenë emocionalisht shpërthyes, Rei shkon tek i ati, i cili është shtruar në departamentin psikiatrik të spitalit ku fëmija i Reit sapo kishte lindur dhe i thotë “Je bërë gjysh”. I

ati i përgjigjet, “Unë ndihem si gjysh”. Kjo fjali bie butësisht si një vetëtimë e largët, por prapëseprapë ka efektin e një goditjeje me çekiç.

Në esenë “Mbi të shkruarin” paraqitet kredoja letrare e Reit. Duke iu shmangur atyre që i quan “marifete të ulëta”, ai i gëzohet pa masë punës së të rishkruarit. Është aq guximtar sa mos ta dijë se ku po shkon ndërkohë që shkruan dorëshkrimin e parë. Kujdeset që tregimi të ketë tension, ose siç e quan ai “veprim të pandërprerë”. Ai e di se ç’duhet të lërë jashtë tregimit apo thjesht “nën sipërfaqe”. Mbi të gjitha, hasim urdhrin e prerë për të përdorur “gjuhë të qartë e specifike”, me të cilin ai vendosi standardin për shkrimtarët e brezit të tij.

Homazhi i Reit për Xhon Gardnerin, mësuesin dhe udhërrëfyesin e tij, më bëri të sjell ndër mend udhëtimin tonë përmes një stuhie dëbore për të takuar Xhonin në shtëpinë e tij në Nju-Jorkun e sipërm. Kishim qëndruar duke biseduar gjer në orët e para të mëngjesit, duke shijuar shoqërinë e këtij burri që shqetësohej për Rein dhe të shkruarin e tij, në një kohë kur Rei kishte dëshpërimisht nevojë për këtë, madje edhe i jepte hua çelësat e zyrës së tij që të kishte një vend ku të shkruante. Më vonë, kur Xhoni vdiq në një aksident me motor, Rei dhe unë u kujtuam se Xhoni s’kish dashur të shtrihej natën e fundit që kaluam bashkë.

Është e natyrshme të duash të dish se ku e filloi rrugëtimin një shkrimtar që e admirojmë dhe tregimi i parë i botuar i Reit “Stinë të furishme” shënon

pikërisht këtë fillim, me Folknerin (Faulkner) dhe Xhojsin (Joyce) si mentorë. Gjithashtu, kemi edhe tregimin si xhevahir të papërpunuar “Qimja”, që duket si paraardhësi i tregimit të mëvonshëm “Kujdes”. Te “Qimja” ne bëhemi dëshmitarë të atij “shqetësimi” të mprehtë për të cilin Rei mori famë. “Aficionados”, gjithashtu i shkruar në këtë periudhë, është një prej dy parodive të vetme që ai botoi. Këtu, nën pseudonimin e Xhon Vejl (John Vale), ai vë në lojë një prej ndikimeve të tij më të njohura. Përpos gjithçkaje, Hemingueji mbeti një prej modeleve të rëndësishme letrare, i cili më vonë do t’ia hapte rrugën Çehovit.

Kritikat, parathëniet dhe esetë e tjera që përmbli-dhen këtu na kujtojnë entuziazmin e Reit: dashurinë e tij për një “lexim të mirë”, trillet e personazheve dhe kthesat e papritura të subjektit. Gjithnjë bëhet fjalë për autoritetin e të pasurit diçka të rëndësishme për të thënë. Ndërkohë që lexojmë se çfarë thotë Rei mbi mësimdhënien e shkrimit artistik apo arsyet e tij pas përzgjedhjeve për një antologji, ne nxjerrim këshilla nga respekti i tij për “përshkrimin e gjallë të vendeve” apo “intensitetin demoniak” dhe ndërgjegjësimin rreth asaj që është “e rëndësishme”: “dashuria, vdekja, ëndrrat, ambicia, rritja, pranimi i limiteve të tua dhe të njerëzve të tjerë”. Rei e kuptonte të shkruarin si proces zbulimi dhe eseja e tij “Mbi të shkruarin” thekson rëndësinë e të rishkruarit si mjet për ta hapur tregimin dhe për të zbuluar se përse po shkruhet ky tregim, në fund të fundit.

Kam respekt dhe dashuri të madhe për shkrimet e përmbledhura në këtë libër, jo vetëm për vlerën e tyre biografike dhe letrare, por edhe për pasionin dhe qartësinë e tyre. Ashtu si në botimin e parë të “S’ka heroizma, të lutem”, i jam tejet mirënjohëse Uilliam Stallit, i cili përmbledhi pjesëzat e veçanta të Reit nga gazeta dhe revista të ndryshme. Do t’i jem gjithnjë mirënjohëse Xhei Udrufit për dashamirësinë e tij personale dhe për bashkëpunimin gjatë gjithë fazave të prezantimit të tri tregimeve që zbuluam: puna jonë mbështeti një miqësi të vërtetë.

Këtu në Northuest ne nxjerrim shpeshherë jashtë fuqitë e shiut në mënyrë që të kapim bollëkun e natyrës. Uji i shiut na siguron një rezervë të madhe uji të butë për t’u larë ose për të ujitur lulet. Ky libër është si shiu i mbledhur në një fuçi, ujë i mbledhur drejt e nga qielli. Mund të kridhemi në të kurdoherë dhe të gjejmë diçka që na freskon e na përmbush nevojat, që na afron përsëri me jetën dhe punën e Reimond Karverit.

Tess Gallagher
Rixh Haus
Port Anxheles, Uashington
Janar 2000